

VIZITË XHAMIVE TË ZVICRËS

Në agimin e 6 prillit, xhamia e Wil-it kishte xhematë si kurrë më parë. Për të falur namazin e sabahut kishin ardhur të gjithë nxënësit që ndjekin mësim-besimin në xhami, një pjesë nga ta edhe me prindërit e tyre. Kjo ardhje nuk ishte e rastësishme, sepse këtë ditë ata e kishin pritur me padurim, pasi që hoxha i tyre iu kish premtuar se do të bëjë çmos për të organizuar një shëtitje nëpër zvicër ku do të mund ti vizitojnë xhamitë më të mëdha të Zvicrës.

Pas faljes së namazit, nxënësit morrën udhëzimet e duhura nga organizatori, dhe i zurën vendet e tyre në dy Autobusët njëri prej tyre me dy kate e njëri normal, ku numri në përgjithsi kaplonte 110-tën. Drejtimin të cilin e morën Autobusët ishte Wil – Gjënëvë, xhamia e së cilit qytet ishte e para në listë për vizitë. Për ne prindërit nuk ishte ky relacion i lodhëshëm fare, ngashkaku se me vehte kishim nxënës të entuziazmuar dhe kureshtarë për këtë ekskurzion, sa që për asnjë moment nuk na lanë të mërzitemi me zërët e tyre të bukur në këndimin e ilahijeve dhe kasideve, me recitimet e tyre, me pyetjet e tyre të shumta dhe emitimin e hoxhallarëve në veshje dhe të ndryshme. Pas një pushimit diku në mes të rrugës, ku tërë nxënësit morën fotografia të shumta nga të 110 udhëtarët, filloi rruga për në Gjënëvë, ku pa mos e kujtuar fare aritjen, ne vetëm se ishim atje.

Xhamia e Gjënëvës një objekt imponant Islam apo me tjetër fjalë personifikim i muslimanëve që jetojnë dhe veprojnë në Zvicër.

Që të kemi një pamje më të qartë për xhaminë, këtë e ndihmoi z. Hasani nga Algjeria i cili ishte në pritjen tonë. Ky person tregoi se kjo xhami është ndërtuar kah fundi i vitit 1980, ndërtim i cili zgjati më se tri vite. Shumën e paparamenduar të ndërtimit që kalonte 8 Milion CHF.- e kishte financuar mbreti i kaluar i Arabisë Saudite, mbreti Fejsal ibn Abdul Aziz Allahu e shpërbleftë.

Kjo xhami ka kapacitet që të e kryejnë faljen e namazit 3500 persona pa i llogaritur edhe objektet përcjellëse që u ndërtuan disa vite më vonë. Përballë faltorese që posendonte një **iluster** më madhësi mbi se 5 m., gjendej biblioteka me shumë e shumë tituj të ndryshëm e me një sallë fascionuse për lexim. Në xhami frekuentojnë besimtarë me nacionalitete të ndryshme, e më së shumti këte e dokumenton edhe ligjeratat tre gjuhëshe, Arabisht, Frengjisht dhe Anglisht, të Imamit Shejkh Rashid nga Libia.

Klasat e shumta me mjete më të rreja teknologjike, ia bëjnë me dije vizituesit numrin e madh të nxënësve dhe angazhimin e palodhur të këtyre rrobërve të Allahut. Me uljen e nxënësve në faltore ku përpara qëndronte udhëheqësi z. Hasani i cili fliste në gjuhën arabe dhe përkthyesi-imami ynë, shpërthyen pyetjet e shumta nga nxënësit. Në mesin e shumë pyetjeve ishte edhe ajo se kush financon momentalisht këtë objekt gjigant dhe me harxhime të plota.

Lidhja Islame botërore –Saudite me seli në Gjënëvë, e cila edhe shumë objekte tjera të botës i financon së bashku me imamët e tyre.

U nisëm për në xhaminë e Bernit, pasiqë plani ishte ashtu, dhe koha ishte e shkurtë, e shiqimet e nxënësve mbeten prapa duke lënë pas minaren e xhamisë që sponte qiellin në lartësi.

Gjatë rrugës realizuam edhe disa pjesëmarës të këtij ekskurzionit.

Alirehat Ismani që banon në Wattwil, ndihmës organizatori dhe anëtarë i kryesisë së Xhamisë – Wil, thot, jam shumë i kënaqur që kishim mundësinë e organizimit vetëm e vetëm të kënaqen fëmijët tanë. Ne do të japim gjithçka si prind për plotësimin e kushteve të gjeneratës së re.

Gëzime Rexhepi 12 vjeçare nxënëse që ndjek mësim-besimin Islam në Uzwil, thot për mua është një kënaqësi e papërshkruar se në këtë rast mund jovetëm të shëtisim, por edhe ne nxënësit të tubohemi dhe njihemi se jemi të njëjtës fe dhe xhami.

Valbona Alili 15 vjeçare thot se për mua është një gjë tepër e qëlluar ku mund të njoftohemi të gjithë.

I nderuari Imam dhe organizatorë i ekskurzionit z. Bekim Alimi:

Çka ju shtyri të organizoni një gjë të tillë?

Ai shtoi se pasiqë klasat e xhamisë llogariten një shkollë e plotë dhe ne dimë se zakonisht shkollat organizojnë edhe shëtitje të ndryshme. Ky organizim kishte pakashumë karakter fetarë ku vizitohen xhamitë e Zvicrës dhe në të njëjtën kohë edhe shëtitje.

Pse vendosët ta vizitoni xhaminë e Gjenevës së pari?

Dihet se nga xhamitë e Zvicrës kjo është e vetmja xhami Islame me minare gjë që ua kujton nxënësve xhamitë e vendlidjes dhe ju bën me dije edhe për organizimin e xhamive tjera edhe më të mëdhaja se jona në Zvicër.

Si ishte reagimi i nxënësve kur dëgjuan për këtë ekskurzion?

Piskëllima e tyre tregoi se me padurim kishin pritur një gjë të tillë. Këtë e tregon entuziazmi në fytyrat e tyre dhe numri i nxënësve që u përgjigj.

Ajvas Ameti, prind: Mendoj se ideja është e qëlluar dhe në kohë të qëlluar, por disciplina jo në nivel.

Arritëm në xhaminë e Bern-it, ku Imami i saj sipas rezervimit telefonik duheshte të pres në xhami, por për fat të keq kjo nuk ndodhi. Aty, pasiqë dyert e xhamisë ishin të hapura, e falëm namazin e drekës dhe u nisëm menjëherë për në Restorantin e një bashkatdhetarit i cili me palodhje na shërbeu të gjithëve edhe pas ngatresave nga fëmijët e shumtë. Kjo ate fare nuk e besdisi, gjë për të cilën meriton falemenderimin tonë. Pasi 110 persona për një kohë 60 minutëshe hëngrën drekë, u nisëm për në xhaminë e Zhürich-ut ku aty na priste imami, xhemaati me një desert të shtruar. E falëm namazin e ikindisë dhe dolëm nag pjesa tjetër e xhamisë ku imami h. Nebi ef. Rexhepi iu mbajti fëmijëve një fjalim të shkurtër duke i motivuar edhe më tepër për ndjekjen e mësim-besimit Islam.

Në emër të të gjithë nxënësve Eljesa Alili nxënëse nga Wattwili e falemenderoi Xhaminë dhe udhëheqësit e saj për mikpritjen e bukur.

Prej aty u nisëm drejt për në Wil, ku në orën 21.00 ishim pranë xhamisë prej ku u nisëm.

Përpara se të ndahen nxënësit nëpër shtëpia, Imami i tyre i tuboi dhe i pyeti me zë të lartë:

A kalut mirë? Përgjigja ishte një PO aq e fuqishme sa që prindërit që kishin ardhur për ti pritur fëmijët i kaploi vaji nag malli.

Allahu qoftë i kënaqur nga kjo punë ynja.